



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered		31-05	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMBHDK	2755/2021		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.320/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2701/2019 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A/02/07/2015 të datës 09.01.2015 të parashtruar nga Sindikata e Universitetit dhe Shkencës së Kosovës në emër të ankuesit të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati

me adresë Rr. "A.Zhitia" p/n, Mitrovicë, kundër organit të punësimit/Universitetit të Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.05.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A/02/07/2015 e datës 09.01.2015 e parashtruar nga Sindikata e Universitetit dhe Shkencës së Kosovës, në emër të ankuesit të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati

A r s y e t i m

Sindikata e Universitetit dhe Shkencës së Kosovës, në emër të ankuesit më datë 09.01.2015 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 20/2015 të regjistruar me numër A/02/07/2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.2/986 të datës 30.12.2014 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së pagës prej 30% duke filluar nga data 01.01.2011, sipas Vendimit Nr.02/151 të datës 06.01.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi, me datë 19.01.2015 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Këshilli më datë 30.01.2015 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës 1/6.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.03.2015 ka nxjerr Vendimin me numër A/02/07/2015 përmes të cilit ka hedhur poshtë ankesën si të palejuar.

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me datë 02.05.2018 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar Vendimin A/02/07/2015 te datës 05.03.2015 dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 15.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2701/2019 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e parashtruar nga Sindikata e Universitetit dhe Shkencës së Kosovës, e regjistruar në emër të ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 09.01.2015 me numër protokoli 20/2015 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e Punës te datës 26.10.2005, 17.11.2005, 30.10.2008; Vendimin me Nr.02/151 të datës 06.01.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Opinionin Ligjor të datës 25.03.2014 të Ministrisë së Administratës Publike; Vendimin me Nr. prot:1/355 të datës 11.07.2014 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës; Ankesën e datës 07.11.2014 të parashtruar në Komisionin për Ankesa të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"; Vendimin me Nr.prot:2/986 të datës 30.12.2014 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës; Kërkesën për konfirmim zyrtar te datës 24.03.2014; Vendimin A/02/07/2015 te datës 05.03.2015 te Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktvendimin e datës 20.03.2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Padinë e datës 15.04.2015; Përgjigjen në padi te datës 20.02.2018; Procesverbalin mbi shqyrtimin kryesor A.nr.685/15 të datës 02.05.2018; Aktgjykimin A.nr.685/15 të datës 02.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën e datës 20.06.2018; Aktgjykimin AA.nr.302/2019 të datës 01.10.2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Autorizimin e datës 11.04.2019; Kërkesën e datës 01.11.2019 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin lidhur me kërkesë i datës 04.11.2019; Kërkesën e datës 09.12.2019 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin lidhur me kërkesë i datës 10.12.2019; Aktgjykimin A.nr.2701/2019 të datës 15.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën e datës 30.04.2021 dhe 07.05.2021 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës një nga një dhe të gjitha se bashku ka konstatuar se ankesa e Sindikatës së Universitetit dhe Shkencës së Kosovës e regjistruar në emër të ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Bazuar në provat e lëndës, është konstatuar se Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me datë 11.07.2014 ka nxjerr Vendimin me Nr.prot: 1/355 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e punonjësve të Administratës së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe të Këshillit Grevist, për kompensimin retroaktiv të diferencës së të ardhurave personale nga ngritja e pagave të shërbyesve civilë, në vlerë 30% prej vitit 2011.

Sindikata e Universitetit dhe Shkencës së Kosovës (SUSHK), kundër Vendimit Nr.prot: 1/355 të datës 11.07.2014 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, me datë 07.11.2014 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesave pranë Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës. Këshilli Drejtues, me datë 30.12.2014 ka nxjerr Vendim me Nr.port:2/986 me të cilin ka refuzuar ankesën e datës 07.11.2014 të Sindikatës të Universitetit dhe Shkencës së Kosovës.

Të pakënaqur me Vendimin me Nr.port:2/986 të datës 30.12.2014 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Sindikata e Universitetit dhe Shkencës së Kosovës, përmes kryetarit të Sindikatës, me datë 09.01.2015, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së pagës prej 30% për punonjësit e Administratës së Universitetit të Prishtinës, duke filluar nga data 01.01.2011, sipas Vendimit Nr.02/151 të datës 06.01.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërsa me datë 07.05.2021, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve, avokati përmes shkresës me numër protokollit 2273/2021 ka precizuar ankesën e datës 09.01.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesve, ka analizuar dispozitat e legjislacionit të aplikueshëm në kohën kur është parashtruar ankesa, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, përkatësisht nenin 127 ku përcaktohet se: 2. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ; dhe nenin 130 ku përcaktohet se: 1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin., si dhe dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht nenin 8 paragrafi 2 ku përcaktohet se: Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, si dhe duke marr parasysh se Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me datë 11.07.2014 ka nxjerr Vendimin me Nr.prot: 1/355 përmes të cilit ka refuzuar kërkesën e punonjësve të Administratës së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe të Këshillit Grevist, për kompensimin retroaktiv të diferencës së të ardhurave personale, ndërsa ankuesit kundër këtij vendimi kanë parashtruar ankesë me datë 07.11.2014 në Komisionin e Ankesave të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, Kolegji konstaton se ankesa e parashtruar në Komisionin për Ankesa pranë Këshillit Drejtues të Universitetit të



Prishtinës, është ushtruar jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 130.1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se ankesa me numër A/02/07/2015 e datës 09.01.2015 është e pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.320/2021

Aydyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar, Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.